



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12, 51 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Udhëzimit administrativ nr.03/2014 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komuniteteve të përhershme në Komunë, Udhëzimit administrativ (MAPL) Nr.02/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.03/2014 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komuniteteve të përhershme në Komunë Nr.0-1498 të datës 31.12.2018 si dhe nenit 20 par. 20.1, 33 dhe 35 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dates 26.09.2008, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës kërkon nga Kuvendi i Komunës që në mbledhjen e mbajtur me 19.01.2021, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

V E N D I M
PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARIT TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

Neni 1

Zëvendësimi i anëtarit të Komitetit për Komunitete

Me këtë Vendim, zëvendësohet ish-anëtari i komitetit për komunitete z. Ferat Gashi nga komuniteti rom për shkak të vdekjes i caktuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës për themelimin e Komitetit për Komunitete 15Nr.020-67918 të datës 22.12.2017, në numrin rendor 5 dhe në vend të tij CAKTOHET Znj. Nadije Gasi nga Janjeva poashtu nga komuniteti rom konform kërkesës së parashtruar nga Komuniteti rom 1-020-63480 të datës 30.12.2020.

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi

Detyrat , përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi i anëtarëve të Komitetit për Komunitete janë të përcaktuara me dispozitat e neneve 51 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 33 dhe 35 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Udhëzimit administrativ nr.03/2014 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komuniteteve të përhershme në Komunë , Vendimit të Kuvendit të Komunës për themelimin e Komitetit për Komunitete 15Nr.020-67918 të datës 22.12.2017 si dhe Udhëzimit administrativ (MAPL) Nr.02/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.03/2014 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komuniteteve të përhershme në Komunë Nr.0-1498 të datës 31.12.2018.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas e publikimit në WebFaqen e Komunës.

15Nr. 020-4345
Lipjan, më 19. 01. 2021

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

